



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	06.07.2026
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – QERSHOR - 2026

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2026, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.06.2026-30.06.2026
(QERSHOR – 2026)

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit qershor 2026-janë pranuar gjithsejtë 66¹-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraparak kanë qenë 10 lëndë, në total 66 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 63 kërkesa, 40 të miratuara 22 të refuzuara dhe 1 e ceduar. Për shqyrtim në muajin vijues (korrik 2026) barten 13 lëndë/kërkesa të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare - 2.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera, DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është procesi i dërgimit të ftesave – atëherë kur lënda nuk është e kompletuar. Në këtë rast janë dërguar 2 ftesa. Në procesin e përfundimit të lëndëve janë lëshuar konkluzione për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Gjatë muajit qershor, janë lëshuar 4 konkluzione për pagesen e taksave si: 1 për leje ndërtimi, 1 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, 1 për leje rrënimi dhe 1 për legalizim të ndërtesës.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Është proceduar administrativisht kërkesa për organizimin e punëtorisë në nivel të Bordit për finalizimin e PZHK-së

Është përfunduar Raporti 6 mujor për përmbushjen e detyrimeve nga agjenda evropiane.

Hartimi dhe dorëzimi i Raportit për TM1 për leje ndërtimi – Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Formulari për Inventarizimin e shërbimeve administrative – organizata OPED.

Pjesëmarrja në takim me VORAE lidhur me legalizimin e pronave dhe VJF.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare. Procesi mbikëqyret drejtpërdrejt nga DPUMM. Gjatë muajit qershor 2026, në sistemin ARIS janë regjistruar adresat e qytetarëve, regjistrimi i njërive të banimit dhe i hyrjeve në ndërtesat me më shumë se një hyrje.

Tabela 1: Të dhënat lidhur me regjistrimet në sistemin e adresave:

<i>Regjistrimet në sistemin e adresave</i>	<i>Muaji</i>		
	<i>Qershor</i>	<i>Maj</i>	<i>Prill</i>
Adresa të regjistruara të qytetarëve	266	221	204
Regjistrimi i njërive të brendshme	426	547	348
Numri i hyrjeve të regjistruara (vendosura)	120	80	64

Lidhur me aktivitetet për PZHK, edhe gjatë muajit qershor është vazhduar me rishikimin e dokumentit në tërësi. Specifikisht kemi trajtuar Harten për shfrytëzimin e tokës ku është përfshirë e gjithë hapësira e komunës sipas llojeve të destinimit dhe harta për infrastrukturen rrugore në pjesën urbane të qytetit. Me

¹ Janë pranuar edhe 2 kërkesa për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraparakisht.

kompaninë konsulente kemi mbajtur një takim ditor për trajtimin e çështjeve më specifike. Nga Drejtoratet sektoriale është kërkuar rishikimi i fushave përkatëse me qëllim të përmirësimit të të dhënave dhe objektivave të caktuara.

Kemi përmbyllur aktivitetet lidhur me emërtimin e rrugëve të reja dhe e kemi dërguar lëndën për shqyrtim në Kuvendin e Komunës për seancën e radhës.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të bartura;
- Vazhdimi i punimeve në finalizimin e PZHK;
- Përfundimi i Raportit për monitorimin e zbatimit të HZK për periudhën një (1) vjeçare.
- Përfundimi i Raporti 6 mujor për punën e DPUMM.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 2.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuara	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	13	2	6		4		5
2.	Leje ndërtimi	5	2	2		3		2
3.	Ndryshim i L. ndërtimo.	1				1		
4.	Vazhdim i KN	1		1				
5.	Leje renovimi	2		2				
6.	Leje mjedisore (LMK)	1	1			1		1
8.	Informacione urbane	8		8				
9.	Leje rrënimi	1		1				
10.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	4	2	2		1	1	2
11.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
12.	Bashkim/ndarje e parcelave	3	1	2		2		
13.	QRTK- kërkesë pl.dok.	1		1				
14.	Tërheqje lande	2		2				
15.	Panele solare-KN		2	1		1		
16.	Pëlqim për solar në ndërtesë	1				1		
17.	Pëlqim për ndërrim destinimi të tokës	1		1				
18.	Kërkesë për ndërrimin e destinimit të tokës	1				1		
19.	Plotësim i K. Ndërtim.	1		1				
21.	MMPH – pëlq.mjed.	2		1		1		
22.	MMPH- KN për panele solare	1		1				
23.	Vendosje e rrjetit energj.	1				1		

25.	Ndërhyrje në zonën e mbrojtur QRTK	1		1				
27.	Kërkesë për dokumente	1		1				
28.	Emërtim rruge	5				5		
30.	Infrakos- kërkesë për dokumente të pl.hapës.	1		1				
31.	Kërkesë për kopje të LN dhe projektit	2		1				1
32.	Raporti për Agjenden Evropiane	1		1				
33.	Inventarizimi i shërbim. administrative OPED	1		1				
34.	LN – TM1	1		1				
35.	Dokumente shtesë-UBT	1						1
36.	Vlerësim i per.provuese	1						1
	MMPH – Vendrim lidhur me prerjen e drun.	1		1				
	Gjithsejtë:	66	10	40		22	1	13

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 3.

<i>Nr.</i>	<i>Kateg. e ndërtimit</i>	<i>Sipërf. Tokës –m2</i>	<i>Sip.ndëtesës- m2</i>	<i>Destinimi</i>	<i>Vendi</i>
1.	I	500	296.38	Shtëpi	Lipjan
2.	II	116432	2664.25	Administratë MPB	Vrellë e M.

Gjatë muajit qershor është dhënë vetëm një leje e kategorisë së parë dhe një e kategorisë së dytë. Leja e kategorisë së dytë është dhënë për një ndërtesë administrative në Vrellë për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Dy kërkesa janë bartur në proces shqyrtimi në muajin vijues.

Buxheti:

Gjatë muajit qershor 2026 janë realizuar të hyra simbolike nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane.

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....1,262.27€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:500.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej:.....
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....188.92€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej181.23€

Shuma totale e të hyrave:2,132.42€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin qershor 2026 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me shpenzimet kemi proceduar me pagesa për kryerjen e detyrimeve të maturuara për muajin qershor 2026. Mjetet e planifikuara për shpenzim janë nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime”.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit qershor 2026 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.